

Vendim nr. 80 datë 18.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **MIRJAN PETRELA, NATASHA PETRELA, SOKOL PETRELA, KLITON PETRELA,** përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokate Nertila Qordja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve, datë 18.07.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosfillimin e hetimit për materialin kallëzues nr. 9052 të vitit 2017; nr. 59, datë 17.01.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-1117, datë 03.07.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, pika 1, dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 31, 71, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2013 kërkuesja Mirjan Petrela bashkë me motrën dhe vëllezërit e saj (trashëgimlënësit e kërkuesve të tjerë) kanë bërë kallëzim penal ndaj shtetasit I.A. i cili, sipas tyre, duke përfitur nga marrëdhëniet e krushqisë, përmes falsifikimit të një sërë dokumentesh dhe duke shpërdoruar besimin e tyre, ka arritur të marrë në dorë një pasuri të konsiderueshme të tyre. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka proceduar penalisht shtetasit I.A. dhe E.H., ku i pari është akuzuar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, “Falsifikimi i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre dhe në bashkëpunim, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Mashtrimi” më shumë se një herë, “Mashtrimi” me pasoja të rënda, e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi 2, 186, paragrafi 3 dhe 25, 186, paragrafi 1, 143, paragrafi 2, 143, paragrafi 3 dhe 22 të Kodit Penal (*KP*). Personi tjetër E.H. është akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre dhe në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 186, paragrafi 3, dhe 25 të *KP*-së.

2. Çështja penale është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas rritit të zakonshëm. Ajo gjykatë nuk ka pranuar që në atë proces penal të shqyrtojë një padi civile të paraqitur nga kallëzuesit, në cilësinë e të dëmtuarve nga vepra penale. Gjatë hetimit gjyqësor, ajo gjykatë ka vendosur edhe kryerjen e riekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit për dokumentet e dyshuara si të falsifikuara, duke caktuar një grup me 5 ekspertë, të cilët kanë përgatitur aktin e ekspertimit nr. 11702, datë 09.12.2015 që është administruar rregullisht si provë në gjykim. Në përfundim të procesit, me vendimin nr. 1672, datë 23.05.2016, ajo gjykatë ka vendosur të deklarojë fajtor dhe të dënojë me burgim të pandehurin I.A. për veprat penale të mashtimit, të parashikuara nga nenet 143, paragrafi 2 dhe 143, paragrafi 3, dhe 22 të *KP*-së. Nga ana tjetër, gjykata ka deklaruar të pafajshëm të dy të pandehurit për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, sipas neneve 186, paragrafi 2, 186, paragrafi 3, 25 dhe 186, paragrafi 1, të *KP*-së, duke u mbështetur edhe në të dhënat e aktit të ekspertimit grafik të marrë si provë gjatë gjykimit të çështjes. Çështja më pas është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 634, datë 24.04.2017, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me disponimet për deklarimin e pafajshëm të të dy të pandehurve për veprat

penale të falsifikimit të dokumenteve. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pushuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit I.A. për veprat penale të mashtrimit. Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur rekurs.

3. Në datën 12.07.2017 kërkueset Mirjan dhe Natasha Petrela, si dhe trashëgimlënësit e dy kërkuesve të tjerë kanë depozituar në Prokurorinë e Tiranës kallëzim penal me shkrim kundër 5 ekspertëve të thirrur gjatë procesit gjyqësor të çështjes penale kundër shtetasve I.A. dhe E.H. dhe që kishin përgatitur aktin e ekspertimit grafik nr. 11702, datë 09.12.2015, mbi të cilin gjykatat ishin mbështetur në marrjen e vendimeve në atë proces penal. Në kallëzim është parashtruar se për këtë ekspertim organi i prokurorisë ka paraqitur shumë kundërshtime, duke nisur që nga kompetenca e ekspertëve për të bërë ekspertimin, ashtu edhe për faktin se në kryerjen e ekspertimit ata nuk janë mbështetur në disa teknika si, grafometria etj., ndërkohë që konkluzionet e arritura nga ata binin ndesh me atë të ekspertimit të administruar gjatë hetimit paraprak të procedimit penal. Sipas kallëzimit, duke pranuar të kryejnë një ekspertim jashtë kompetencave të tyre, çka dëshmon për pamjaftueshmëri profesionale, ekspertët e kallëzuar kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin në mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, në dëm të interesave të shtetit dhe të familjes së kallëzuesve, ndaj ata ekspertë duhej të hetoheshin për veprën penale të shpërdorimit të detyrës ose për ato vepra penale që organi i prokurorisë do të identifikonte.

4. Për këtë kallëzim, me vendimin e datës 18.07.2017, Prokuroria e Tiranës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke u bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), sipas të cilit procedimi penal nuk mund të fillojë kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston. Në vendimin e tij, prokurori ka arsyetuar se vetëm fakti se përfundimi i aktit të ekspertimit bie në kundërshtim me konkluzionin e një tjetër akti ekspertimi dhe se ekspertët e kallëzuar gjatë punës së tyre nuk kanë marrë parasysh teknika të caktuara të ekspertimit, nuk përmban asnjë provë ose indicie për elemente të ndonjë vepre penale nga ato të kallëzuar. Sipas prokurorit, në kallëzim nuk hidhet asnjë dyshim për kryerjen me dashje të një akti ekspertimi, konkluzioni i të cilit të jetë marrë për interes të personave të tretë ose për përfitime të paligjshme. Vendimi i Prokurorisë së Tiranës është kundërshtuar në gjykatë nga kallëzuesit, duke pretenduar se organi i akuzës nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me aftësitë profesionale të ekspertëve të kallëzuar dhe se përse ata kanë pranuar të kryejnë një akt ekspertimi jashtë kompetencave të tyre, ndërsa kanë ditur që nuk janë ekspertë të fushës.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 50 të regjistrit themeltar, datë 27.10.2017, ka pranuar ankimin e kallëzuesve, duke vendosur prishjen e vendimit të Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin procedimit penal dhe urdhëruar vazhdimin e hetimeve.

Sipas asaj gjykate, Prokuroria e Tiranës nuk ka arsyetuar për përfundimin e arritur se në kallëzim nuk hidhet asnjë dyshim mbi kryerjen me dashje të një akti ekspertimi, konkluzioni i të cilit të jetë marrë për interes të personave të tretë ose për përfitime të paligjshme, ndërkohë që pikërisht ky fakt duhet të hetohet për të sqaruar mënyrën e përmbushjes, në gjykimin penal, të detyrës së ekspertit nga personat e kallëzuar në lidhje me interesat e ligjshëm të kallëzuesve, për mënyrën e caktimit të tyre në grupin e ekspertëve, nëse nuk kanë qenë specialistë të fushës për të cilën u është kërkuar mendimi etj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 59, datë 17.01.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e kërkesës ankimore të kallëzuesve dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë nuk ka caktuar asnjë detyrë konkrete që eventualisht mund të kryente prokuroria dhe asnjë prej orientimeve të saj nuk sjell elemente të veprës penale prej ekspertëve të kallëzuar, pasi të gjitha këto pretendime janë procedurale dhe zgjidhen në gjykim nëpërmjet ankimit të vendimit në një gjykatë më të lartë. Gjykata e apelit i ka gjetur të drejta përfundimet e prokurorit në vendimin për mosfillimin e procedimit penal, duke evidentuar se caktimin e ekspertëve në gjykimin e çështjes penale gjykata ia ka kërkuar Drejtorisë së Policisë Shkencore, e cila ka relatuar ekspertët në fjalë si ekspertë të fushës përkatëse, ndërkohë që organi i prokurorisë në rast se do të kishte kundërshtime, ato për nga natyra e tyre zgjidhen nëpërmjet ankimit procedural në një gjykatë më të lartë. Sipas asaj gjykate, prokuroria nuk është dhe nuk mund të trajtohet si mjet për të pretenduar pavlefshmërinë e një ekspertimi të kryer në një gjykim civil ose penal, aq më tepër kur kallëzimi penal, në rastin konkret, është bërë disa muaj pas përfundimit të gjykimit të çështjes penale në gjykatën e apelit.

7. Mbi rekursin e kallëzuesve Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1117, datë 03.07.2023, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së.

8. Në datën 29.02.2024, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual sipas objektit në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 01.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

9. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsytimit të vendimeve dhe parimi i barazisë së armëve*, pasi:

- 9.1 Prokuroria e Tiranës duhej të verifikonte rrethanat e përcaktuara në nenin 290 të KPP-së dhe të parashtronte shpjegime për zbatimin e kësaj dispozite, në rastin konkret. Analizimi i provave nga Prokuroria e Tiranës, pikërisht i vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin penal ku u administrua si provë ekspertimi grafik, ishte i një rëndësie thelbësore për të kuptuar profilin e kompetencave që duhej të kishin ekspertët për t’iu përgjigjur pyetjeve teknike të ngritura nga gjykata dhe palët në atë proces, me qëllim verifikimin e faktit nëse ata i plotësonin ose jo kriteret e nenit 179 të KPP-së për hartimin e aktit të ekspertimit, si dhe për dyshimet e ngritura nga kërkuesit lidhur me analizën dhe konkluzionet e atij akti.
- 9.2 Gjykata e apelit, pa hetuar nëse ekspertët e thirrur në gjykimin e çështjes penale kishin formimin e përshtatshëm profesional për të kryer ekspertizën, ka krijuar një praktikë të gabuar në interpretimin dhe zbatimin e neneve 248 dhe 309 të KP-së, si edhe të neneve 176, 179, 181 dhe 366 të KPP-së, për shkak se barazon barrën e provës për kallëzimin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe të ekspertimit të rremë me atë të aktit të ekspertimit si provë në gjykimin civil. Gjykata e apelit nuk ka parashtruar arsye konkrete se përse ka pranuar si të drejtë vendimin e Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e hetimit dhe nuk ka ballafaquar argumentet dhe provat e palëve në proces.
- 9.3 Gjykata e Lartë duhej të ushtronte kompetencat e saj sipas nenit 432 të KPP-së, ushtrim ky që kishte rëndësi thelbësore për kërkuesit në kushtet kur ata nuk kanë pasur mundësi të ngrinin dyshimet e tyre për ekspertët gjatë gjykimit të çështjes penale, duke qenë se kërkesa e tyre u rrëzua për të ngritur pretendime civile në procesin penal. Ajo gjykatë në pjesën hyrëse të vendimit i ka cituar shkaqet e kësaj dispozite, por nuk i ka analizuar ato. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk kuptohet se cilave pretendime në rekurs u referohet ajo në konkluzionet e saj, duke qenë i errët arsyetimi i vendimit në atë masë që cenon në thelb të drejtën e kërkuesve për mjete juridike efektive, vendime të arsyetuara dhe barazi të armëve në proces.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134, të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 03.07.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 29.02.2024, ndërkohë që referuar shkresës nr. 1383/1 prot., datë 18.03.2024 të Gjykatës së Lartë, vendimi i saj në fjalë është bërë i disponueshëm për palët në datën 30.10.2023, çka tregon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se, ndër të tjera, kërkuessit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta e aksesit substancial, standardi i arsytimit të vendimeve dhe parimi i barazisë së armëve nga Prokuroria e Tiranës, duke argumentuar se ajo duhej të verifikonte rrethanat e përcaktuara në nenin 290 të KPP-së dhe të parashtronte shpjegime për zbatimin e kësaj dispozite, në rastin konkret. Sipas kërkuessve, analizimi i provave nga Prokuroria e Tiranës, pikërisht i vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin penal ku u administrua si provë ekspertimi grafik, ishte i një rëndësie thelbësore për të kuptuar profilin e kompetencave që duhej të kishin ekspertët për t’iu përgjigjur pyetjeve teknike të ngritura nga gjykata dhe palët në atë proces, me qëllim verifikimin e faktit nëse ata i plotësonin ose jo kriteret e nenit 179 të KPP-së për hartimin e aktit të ekspertimit, si dhe për dyshimet e ngritura nga kërkuessit lidhur me analizën dhe konkluzionet e atij akti.

15. Gjithashtu, kërkesit kanë pretenduar se e drejta e aksesit substancial, standardi i arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe parimi i barazisë së armëve janë cenuar edhe nga gjykata e apelit, duke argumentuar se ajo gjykatë, pa hetuar nëse ekspertët, në rastin konkret, kishin formimin e përshtatshëm profesional për të kryer ekspertizën e kërkuar nga gjykata, ka krijuar një praktikë të gabuar në interpretimin dhe zbatimin e neneve 248 dhe 309 të KP-së, si dhe neneve 176, 179, 181 dhe 366 të KPP-së, për shkak se barazon barrën e provës për kallëzimin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe të ekspertimit të rremë me atë të aktit të ekspertimit si provë në gjykimin civil. Sipas kërkesit, gjykata e apelit nuk ka parashtruar arsye konkrete se përse ka pranuar si të drejtë vendimin e Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e hetimit dhe nuk ka ballafaquar argumentet dhe provat e palëve në proces.

16. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më lart, në lidhje me pretendimet e kërkesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të barazisë së armëve nga Prokuroria e Tiranës dhe gjykata e apelit, Kolegji evidenton se argumentet e tyre në këtë drejtim kanë të bëjnë tërësisht me mënyrën e vlerësimit të provave, interpretimit dhe zbatimit të ligjit, të cilat për nga natyra hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Kërkesit nuk kanë sjellë asnjë argument konkret kushtetues se si Prokuroria e Tiranës ose gjykata e apelit kanë cenuar të drejtën e tyre për proces të rregullt, përkundrazi argumentet që kanë sjellë në këtë drejtim i referohen vetëm vlerësimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm pretendimeve të tyre. Si të tilla, këto pretendime nuk mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues.

18. Po kështu, Kolegji vëren se kërkesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta e aksesit substancial, standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimi i barazisë së armëve edhe nga Gjykata e Lartë, duke argumentuar, në thelb, se ajo duhej të ushtronte kompetencat e saj sipas nenit 432 të KPP-së, ndërkohë që nuk ka analizuar shkaqet e rekursit dhe arsyetuar në lidhje me to, duke qenë i errët vendimi i saj. Duke pasur në konsideratë këto argumente, Kolegji

do ta trajtojë çështjen në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar kompetencat e saj sipas nenit 432 të KPP-së. Sipas kërkesve, ajo gjykatë në pjesën hyrëse të vendimit vetëm sa i ka cituar shkaqet e rekursit, sipas kësaj dispozite, por nuk ka analizuar shkaqet e parashtruara në rekursin e tyre. Gjithashtu, kërkesit kanë pretenduar se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk kuptohet se cilave pretendime në rekurs u referohej ajo në konkluzionet e saj, duke qenë i errët arsytimi i vendimit në atë masë që cenon në thelb të drejtën e kërkesve për mjete juridike efektive, vendime të arsyetuara dhe barazi të armëve në proces.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2022; nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 30, datë 30.03.2017; nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palëve

ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga kërkuesit, për të cilin, pasi ka marrë në shqyrtim dhe vlerësuar shkaqet e parashtruara, ajo ka dhënë vendim në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e tij, ndërsa ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit është i argumentuar mjaftueshëm, në përputhje me ligjin procedural penal, ku nga shqyrtimi në tërësi i akteve dhe referuar dispozitave procedurale penale në lidhje me kontrollin nga gjykata të vendimmarrjes së prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, ka konkluduar se faktet e kallëzuar nuk përmbanin elemente të ndonjë vepre penale. Në raport me pretendimet e parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzionin se nuk konstatohen shkelje ose zbatim të gabuar të ligjit penal material apo procedural nga ana e gjykatës së apelit me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohen shkelje me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, apo shkelje të tilla procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe nuk evidenton që vendimmarrja e gjykatës së apelit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

24. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se shkaqet e rekursit që lidhen me marrjen e provave, pa argumentuar shkeljet e ligjit, në respektim të nenit 432 të KPP-së, dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar të papranueshëm pretendimin e ngritur nga ankuesit në rekurs për mospasjen e një mjeti tjetër ligjor për të kundërshtuar shkeljet e pretenduara të ekspertëve të kallëzuar në procesin gjyqësor penal që ka prodhuar aktin e ekspertimit, në rrethanat kur ata nuk kanë qenë palë në këtë proces dhe kur organi i akuzës nuk ka ushtruarrekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit. Sipas asaj gjykate, në rastin konkret, objekt shqyrtimi në gjykatat e faktit ka qenë kontrolli i vendimmarrjes së prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në raport me ligjin penal, ndërkohë që pretendimet e ankuesve kanë të bëjnë me rrethana procedurale të një procesi tjetër gjyqësor.

25. Fillimisht, Kolegji vlerëson të theksojë se, në thelb, pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit, më së pari, duket se lidhen me procesin penal të themelit të zhvilluar kundër shtetasve I.A. dhe E.H. Parimisht, aksesit në drejtësi i viktimës së veprës penale nënkupton të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore që i akordohen viktimës për të vënë në vend të drejtat e cenuara, si dhe për të përfituar nga mjete ligjore nëpërmjet institucioneve të drejtësisë. Vlen të përmendet se përpara ndryshimeve të KPP-së në vitin 2017, aksesit në

drejtësi i viktimës nga vepra penale ka qenë i kufizuar. Në bazë të nenit 58 të pandryshuar të KPP-së, roli i kufizuar i viktimës nga vepra penale në procesin penal konsistonte vetëm në të drejta që kishin të bënin me fillimin e procedimit penal dhe kërkimin e dëmshpërblimit, ndërkohë që legjislacioni nuk i garantonte të drejtën e informimit për gjendjen e procedimit, pjesëmarrjen dhe mbrojtjen me mjete ligjore procedurale efektive. Pas ndryshimeve të KPP-së në vitin 2017, aksesit në drejtësi i viktimës nga vepra penale në procesin penal është zgjeruar duke pasur ajo, ndër të tjera, edhe të drejtën e pjesëmarrjes me këtë status në gjykimin e procedimit penal, por duke mos pasur sërish të drejtën e ankimit ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatave. Për këtë aspekt, siç duket ligjvënësi ka vijuar të konsiderojë se mbrojtja e interesave të viktimës në gjykim bëhet nga organi i prokurorisë, që jo vetëm ushtron ndjekjen penale si detyrë ekskluzive të shtetit, por edhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të tij (neni 148, pika 1, i Kushtetutës), duke garantuar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të shoqërisë.

26. Në këtë kuptim, ndërsa thelbi i pretendimit të kërkuesve lidhet me aspektin procedural të marrjes dhe vlerësimit të një prove në procesin penal të themelit, në të cilin si pasojë civile e veprave penale është konsideruar humbja pasurore e tyre, çdo kundërshti në këtë drejtim ka qenë objekt trajtimi brenda atij procesi gjyqësor, pavarësisht se në këtë proces kërkuesit (ose trashëgimlënësit e tyre) nuk kanë qenë pjesëmarrës, por interesat e tyre prezumohet se janë mbrojtur nga organi i akuzës. Fakti që ky i fundit është pajtuar me vendimin e gjykatës së apelit duke mos paraqitur ankim (rekurs) në gjykatën më të lartë (Gjykatën e Lartë), bën që vendimi i asaj gjykate tashmë të konsiderohet si përfundimtar (*res judicata*), që, si i tillë, nuk mund të vihet më në diskutim nga gjykatat për aspektet e trajtuara prej tij dhe as mund të rishikohet nga ato, për sa kohë, nisur nga natyra e tij (vendim pafajësie për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve), ligji e ndalon një gjë të tillë (neni 449, pika 2, i KPP-së).

27. Lidhur me procesin gjyqësor të kundërshtuar nëpërmjet ankimit kushtetues, Kolegji konstaton se kërkuesit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e tyre të aksesit me paraqitjen e rekursit në Gjykatë të Lartë, duke marrë edhe përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura. Fakti se ata nuk kanë marrë arsyetim të detajuar për çdo pretendim të ngritur, nuk do të thotë se pretendimet e tyre nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, për sa kohë kjo e fundit i ka dhënë përgjigje në thelb pretendimit kryesor të tyre, që lidhet me vendimin e gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal. Në këtë kuptim, Kolegji rithekson faktin se një vendimmarrje e tillë në dhomën e këshillimit nuk cenon të drejtën e aksesit, pasi verifikimi i shkaqeve të rekursit me pasojë mospranimin e tij është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë, pikërisht shqyrtimit vetëm të

atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Gjithashtu, referuar edhe standardeve kushtetuese për arsyetimin e vendimeve, Kolegji vëren se Kolegji Penal i Gjykatës e Lartë e ka përmbushur detyrimin e tij për arsyetimin e vendimit, sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara.

28. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.